



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit
të Përgjithshëm Shkodër**

Numri i Çështjes	58325-03348-51-2024	Data e Regjistrimit	02/12/2024
Numri i Vendimit	51-2025-798	Data e Vendimit	04/03/2025

**VENDIM
NE EMER TE REPUBLIKËS**

**Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër
E PERBERE NGA:**

KRYESUES: Albert Keraj

ANËTAR

SEKRETARE Adela Lipe

Objekti: Dergimin e ceshtjes ne gjyq per proc*****penal nr*****1506/2023 me te
pandehur ***** Gila per vepren penale neni 283 K*****penal

Baza Ligjore : neni 283 K.penal

Përmbledhja e vendimit:

,

Nr***282/1855 (58325-03348) Regj***** Them*****
Nr*****245 (798) Vendimi**

Data e ardhjes 02***12*****2024**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit
të Përgjithshëm Shkodër**

Data 04***03*****2025**

VENDIM

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, e përbërë nga:

GJYQTAR– ALBERT KERAJ

Asistuar nga sekretare gjyqësore seance **Adela Lipe**, sot në datën 04*****03*****2025, me kërkesën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, e përfaqësuar në gjykim nga prokurorja e çështjes **Entela Hasmujaj**, mori nëshqyrtim në seancë gjyqësore çështjen penale në ngarkim të:

Të pandehurit:

******* Gila**, i biri i Jonuz dhe i Naziha, i datëlindjes 24*****02*****1997, lindur dhe banues në lagjen “Partizani”, Shkodër, me shtetësi shqiptare, me gjendje gjyqësore ipadënuar, me gjendje civile beqar, me arsim të mesëm, identifikuar nga aktet menumër personal



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër

J70224071P, mbrojtur nga av*******Alfons Pecaj**, anëtar i
Dhomës së Avokatëve Shkodër*****

Akuzuar: Përkryerjen e veprës penale të prodhimit dhe
shitjes së narkotikëve, parashikuar nga neni 283,
paragrafi i parë i KP*****

Nëpërfundim gjykimit të zhvilluar në prani të prokurores Entela Hasmujaj, tëmbrojtësit të
të pandehurit av***** Alfons Pecaj, në mungesë të vullnetshme të tëpandehurit ***** Gila,
gjykata, pasi shqyrtoi rrethanat e çështjes, çmoi dhevlerësoi në tërësi provat e marra në
seancë gjyqësore nënshtruar rregullave tëgjykimit, si dhe dëgjoi në fazën e shqyrtimit
gjyqësor dhe diskutimitpërfundimtar palët, të cilat deklaruan/kërkuan:

Prokurori: deklariminifajtor të të pandehurit ***** Gila për kryerjen e veprës penale
“Prodhim dhe shitja e narkotikëve” parashikuar nga neni 283/1 i KP, dhe dënimine tij me 5
vjet e 6 muaj burgim;

në zbatim të nenit 406/1 të KPP, tëpandehurit ***** Gila i ulet 1/3 e dënimit të dhënë,
duke u dënuarpërfundimisht me 3 vjet e 8 muaj burgim;

vuajtja e dënimit të kryhet nga ipandehuri ***** Gila në një burg të sigurisë së
zakonshme dhe fillon nga data earrëstimit në flagrancë 05*****12*****2023;

shpenzimet procedurale gjatë hetimeveparaprake, si dhe ato gjyqësore t'i ngarkohen të
pandehurit;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër

Mbrojtësi i të pandehurit: deklarimin fajtor të të pandehurit ***** Gila për kryerjen e veprës penale "Prodhim dhe shitja e narkotikëve" parashikuar nga neni 283/1 i KP, dhe dënime të tij me 5 vite burgim;

në zbatim të nenit 406/1 të KPP, të pandehurit ***** Gila i ulet 1/3 e dënimit, duke e dënuar përfundimisht me 3 vjet e 4 muaj burgim;

në aplikim të nenit 59 të KP kërkojmë pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në periudhë prove përpjesën e pavuajtur të dënimit; vuajtja e dënimit të fillojë nga data 05*****12*****2023, datë e arrestimit të tij në flagrancë; rezulton se deri tani, në përlogaritje edhe të afateve të paraburgimit të ketë vuajtur 22 (njëzet) muaj e 9 (nëntë) ditë ***** Për pjesën e pambetur të dënimit të pezullohet dënimi me burgim dhe të vendoset në periudhë prove prej 2 (dy) vjetësh, 11 (njëmbëdhjetë) muajsh e 12 ditësh;

shpenzimet procedurale gjatë hetimeve paraprake, si dhe ato gjyqësore t'i ngarkohen të pandehurit;

I pandehuri: në mungesë;

VËREN

1*** Procedura*******



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër ka paraqitur kërkesën për dërgiminnë gjyq të çështjes penale nr*****1506 të vitit 2023, në ngarkim të të pandehurit *****Gila, marrë i pandehur dhe akuzuar për kryerjen e veprës penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, parashikuar nga neni 283, paragrafi i parë i KP*****

Mbështetur në nenet 13/2, 69, 74 dhe 76 dhe 332 të KPP, çështja është në juridiksionin dhe kompetencën e kësaj gjykate dhe nuk ka pengesa ligjore për gjykimin e saj***** Kjo çështje penale kështu u kalua për gjykim në seancë paraprake*****

Në seancën paraprake, prokurori paraqiti në mënyrë të përmblodhur rezultatet e hetimeve paraprake dhe provat kumbështetëse të kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq***** Mbrojtja kërkoi që i pandehuri të gjykohej me gjykim të shkurtuar***** I pandehuri i pranishëm në seancë shpreh dakord me kërkesën e mbrojtësit***** Nuk u parashtruan pretendime përpavlefshmëri të akteve të hetimeve paraprake apo kërkesa për marrjen e provave të reja*****

Ndërkaq, njëherazi u kërkua nga mbrojtja që akti i përgjimit ambiental, sepse vendimi për lejimin e përgjimit ambiental nuk respekton nenin 222/2 të KPP***** Sipas mbrojtjes, edhe pse vendimi për lejimin e përgjimit është i motivuar nga prokuroria, mungon akti i njoftimit të gjykatës brenda 24 orëve, në mënyrë të tillë që gjykata të bëjë vlefshësin e vendimit të lejimit*****

Gjykata e rrëzoi këtë kërkesë si të pambështetshme ligj***** Gjykata vëren se mbrojtja kërkon të deklarohet i papërdorshëm një përgjim ambiental i kryer në datën 06*****12*****2023 në ambientet e Komisarit të Policisë Shkodër mes ***** Gilae Ergys Gila***** Ky përgjim është lejuar me vendimin e prokurorisë***** Gjykata vlerëson se, në bazë të nenit 222/8 të KPP, përgjimi në ambientet publike, çfarë janë dhomat e një komisariti policie, është kompetencë ekskluzive e prokurorisë***** Kjo dispozitë parashikon: *“...Në rastet e parashikuara nga neni 221, paragrafi 2, veprimi autorizohet nga prokurori*****”* Neni 221/2 i KPP përcakton: *“...2***** Regjistrimi i fshehtë fotografik, filmik ose me video i personave në vende publike dhe përdorimi i pajisjeve gjurmuese të vendndodhjes lejohen vetëm kur procedohet për vepra të kryera me dashje, për të cilat parashikohet dënim me burgim jo më pak, në maksimum, setre vjet...”* Për përgjimin në ambientet publike, në kushtet e nenit 221/2 të KPP, organi i prokurorisë nuk është detyruar të kërkojë paraprakisht lejen e gjykatës për përgjim, apo t'i kërkojë kësaj të fundit vlefshësin e vendimit të lejimit*****

Në vijim, në përgjigje të kërkesës së të pandehurit dhe mbrojtësit, gjykata vlerësoi se, në kuptim të nenit 403/1 të KPP, kërkesa për të proceduar me ritin e gjyimit të shkurtuar duhet



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër

tëparaqitet nga vetë i pandehuri personalisht, ose nga mbrojtësi i tij meautorizim të posaçëm***** Në rastin konkret, i pandehuri ishte vetë i pranishëm nëseancë dhe i pyetur nga gjykata ai u shpreh se ishte dakord me kërkesën eavokatit***** Kësisoj, gjykata vlerëson se mbrojtësi i të pandehurit legjitimohet të kërkojë procedimin me gjykim të shkurtuar, në vështirim të nenit 403/1 tëKPP*****

Gjykata vëren se, pavarësisht ngaqëndrimi rreth akuzës, nga i pandehuri/mbrojtja nuk është kërkuar marrja eprovave të reja që lidhen me akuzën dhe as deklarimi i pavlefshmërisë së akteveprocedurale (neni 332/c, pika 3 i KPP dhe neni 405, pikat 6 dhe 7 të KPP)*****Gjykata kryesisht konstaton se nuk ngrihen këto elemente: pra nuk konstatohetakte të pavlefshme apo prova të papërdorshme, të tilla që të pamundësojnëzgjidhjen e çështjes***** Konstatohet gjithashtu se vepra penale që akuzohet se kakryer i pandehuri, nuk parashikon dënim me burgim të përjetshëm (neni 403, pika2 e KPP)*****

Sa sipër, gjykata, duke konsideruar faktetmateriale dhe procedurale të çështjes, aktet procedurale dhe provat nëfashikullin gjyqësor, bazuar në dispozitat procedurale të treguara më sipër, sidhe në nenin 402, pika 5 të KPP, pasi mori mendimin e prokurorit,vendosi të pranojë kërkesën e të pandehurit për gjykim të shkurtuar***** Nivlerësim të kësaj gjykate, çështja penale në ngarkim të të pandehurit,domethënë gjykimi i akuzës së ngritur ndaj tij për kryerjen e veprës penale tëparaparë nga neni 283/1 i KP, mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet*****

Në vështirim të nenit 332/ë, pika 4 tëKPP, fashikulli i gjykimi krijohet me aktet e kryera gjatë hetimit paraprak dheato që lidhen me dosjen e masës së sigurimit***** Në zbatim të nenit 371 të KPP,fashikulli i hetimeve paraprake i paraqitur nga prokurori dhe procesverbali iseancës gjyqësore u bënë pjesë e fashikullit të shqyrtimit në themel tëçështjes*****

Procesi ndaj të pandehurit ***** Gila vijoiisi gjykim themeli***** Në bazë të nenit 332/dh, pika 1, shkronja “c” të KPP, palëtu ftuan të paraqesin diskutimet përfundimtare*****

2*** Rrethanat e çështjes*******



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, bashkëlidhur shkresës përcjellëse nr*****17995prot, datë 06*****12*****2023 të Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër, është referuar materiali kallëzues nr*****1847, datë 06*****12*****2023, mbi bazën e të cilit është regjistruar procedimi penal nr*****1506, datë 06*****12*****2023, për veprat penale “*Prodhim dhe shitje e narkotikëve*”, “*Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit*” dhe “*Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive*” parashikuar nga nenet 283,278/3 e 280 të KP, në ngarkim të të pandehurit ***** Gila*****

Për kundërvajtjet penale “*Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit*” dhe “*Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive*” parashikuar nga nenet 278/3 e 280 të KP, në ngarkim të personit nën hetim ***** Gila është vendosur pushimi i pjesshëm të akuzës lidhur me procedimin penal nr*****1506, viti 2023 për këto vepra, pasi ndjekja penale është amnistuar me ligjin nr***** 33/2024 „Për dhënie amnistie“*****

Nga shqyrtimi gjyqësor rezulton:

Në datën 05*****12*****2023 rreth orës 21:00 është paraqitur në Komisaratin e Policisë Shkodër shtetasi Ergys Gila, icili parashtron se që në mëngjes bashkëshortja e tij ka ikur nga banesa dhe nuk është kthyer***** Në bazë të këtij deklarami është arritur të komunikohet me bashkëshorten e këtij shtetasi e cila ka sqaruar se është larguar nga banesa me dëshirën e saj pasi bashkëshorti e kërcënon dhe ai ka një armë***** Në këto kushtenga punonjësit e policisë është shkuar në banesën e shtetasit Ergys Gila, por nuk është konstatuar asgjë e kundraligjshme***** Është kontaktuar përsëri me këtë shtetase, e cila u ka thënë punonjësve të policisë se sendet ndodhen në katin edytë, në banesën e shtetasit ***** Gila, vëllai i shtetasit Ergys Gila***** Në këtë mënyrë është ushtruar kontroll në katin e dytë të kësaj banese, ku janë konstatuar disa sende të kundraligjshme dhe shtetasi Ergys Gila dhe ***** janë shoqëruar në Komisaratin e Policisë për veprime të mëtejshme (*Raport shërbimi datë 05*****12*****2023, i hartuar nga OPGJ Vilson Zhuri e Shaip Goga*)*****

Ngakontrolli i banesës së shtetasit ***** Gila janë gjetur 7 (shtatë) jeleke antiplumb të ngjyrave të ndryshme; 13 pako me ngjyrë dhe arome si ato të cannabis sativës; një kavanoz qelqi me material bimor të dyshuar cannabis sativa; një qese blu me lëndë të dyshuar cannabis sativa; një qese transparente me lëndë të dyshuar cannabis sativa; dy palë doreza të zeza; dy maska të zeza; një maske silikon; dy paruke një gri e një kafe; një skafander ngjyrë e zezë; 4 fisheke 9 mm; një çifte 598884; një brez me 32 fishekë kalibër 12mm; një pincetë e ambalazhuar*****



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër

Nga këqyrja e vendit të ngjarjes datë 5*****12*****2023, e ndodhur në lagjen "Partizani", rruga "Lëvizja e Postribës", kuobjekt këqyrje është kati i dytë i banesës, e pikërisht dhoma e gjumit qëgjendet në anën e majtë të korridorit, i cili kishte pesë dyer***** Gjatëkontrollit në këtë dhomë gjumi, u konstatuan në dollapin e rrobave një qeseplasmasi me 13 (trembëdhjetë) pako të dyshuara cannabis sativa, si ajo eçokollatës së hashashit të vakumosura e me përmasa 7*****2 cmx11*****1 cm e gjerësi 1cm***** Më pas këqyrja ka vazhduar poshtë krevatit në mes të dy dyshekëve, kuështë gjetur një qese plasmasi ngjyrë bojëqielli me material bimor si ajo ecannabis sativës***** Më pas këqyrja ka vazhduar tek parvazi i dritares, kukonstatohet një qese transparente me njësasi të dyshuar cannabis sativa***** Pranë kësaj dritare, mbi komohin janë fiksuardy maska koke ngjyrë të zezë në pjesën e syve të hapur si ato të fabrikuara, sidhe një maske silikonin në formën e fytyres me gjatësi deri ne gjysmen egjoksit, si dhe dy paruke ngjyrë kafe dhe ngjyrë gri***** Gjithashtu, u fiksuan 7(shtatë) jeleke antiplumb, dy në ngjyrë blu, dy ngjyrë e zezë, një bezhë, një ibardhë, një i kamufluar si e ushtrisë kafe e bezhë***** Pas dollapit të rrobave unxorr një kellef arme gjahu ngjyrë e zezë dhe jeshil, si dhe një arme gjahu dygrykëshe me numër S98884 dhe një brez me 32 fisheke të kalibrit 12mm***** Në afersi të dritares në dysHEME u gjet kavanoz qelqi me kapak inoksi, mematerial bimor si ajo e cannabis satives***** Po në pjesën e dritares u gjeten dhembajtëse fishekesh ngjyrë jeshile me katër fisheke në të, të kalibrit 9 mm, tëpagositur***** U bë fiksimi i një skafande ngjyrë të zezë material plastik***** Sendete mësipërme janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale dhe janë dërguarpër ekspertime të mëtejshme***** Këqyrjaështë shoqëruar me tabele fotografike*****

Lënda e dyshuar narkotike, në formë çokollate, është peshuar mepeshoren elektronike ADAMS, në ambjentet e D*****V*****P Shkodër dhe ka rezultuar mepeshë 1 (një) kg e 325 (treqind e njëzete pesë) gram***** Pas peshimit kjo lëndë është futur në qesen e provave materiale me numër unik i qeses C3000872 dhe është dërguar për ekspertim të mëtejshëm në Institutin e Policisë Shkencore*****

Lënda tjetër e dyshuar cannabis sativa është peshuar në peshoren elektronike ADAMS, konkretisht një kavanoz brendatë cilit u konstatua një sasi lënde narkotike me peshë 40 (dyzet) gram e cilaështë futur në qesen me numër Unik B3001048; një qese plastmasi brenda së cilësështë konstatuar një sasi lëndë e dyshuar cannabis sativa, e cila është futur në qesen me numër unik B3001048 me peshë 3*****52 (tre pikë pesëdhjetë e dy) gram dhe një qese plastmasi brenda së cilës është konstatuar një sasi e dyshuar cannabis sativa me peshë 0*****79 (zeropikë shtatëdhjetë e nëntë) gram***** Pesha totale është 44*****31 (katërdhjetë e katërpikë tridhjetë e një) gram***** Kjolëndë e dyshuar cannabis sativa, është futur në qesen e provave me numër unik B3001048*****

Është marrë vendim për kryerjen e ekspertimit kimik për lëndën e dyshuar narkotike***** Nga akti i ekspertimit nr*****12015, datë 26*****12*****2023 për materialin resin, 13 paketime është konkluduar se: "Materialet e ngurta, objekt ekspertimi janë resin produkt bime cannabissativa L***** Analizat GC/MS për materialet e ngurta, objekt ekspertimi treguan praninë e CBN, THC-së"*****



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër

Nga akti i ekspertimit nr*****12052 datë 26*****12*****2023 për materialin bimor, një paketim, është konkluduar se: *“Materiali bimor objekt ekspertimi është cannabis produkt herbal bimecannabis sativa L ***** Analiza me GC/MS për materialin bimor objekt ekspertimitregoi për praninë e THC-së përbërës kimik të bimës cannabis sativa”******

Është marrë vendim për kryerjen e ekspertim teknik balistik për armen e gjahut çifte, me nrS98884, kalibër 12 mm, 32 (tridhjetë e dy) fishekë, 4 (katër) fishekët e pistoletës kalibër 9*****19***** Nga akt Nr*****82, datë 15*****12*****2023 është konkluduar se *arma e gjahut çiftë supersport me nr*****S98884, objekt i këtij ekspertimit është armë e gjahut kalibër 12 prodhim truk, nëgjëndjen që paraqitet është e rregullt teknikisht dhe e përshtatshme për qitje *****32 (tridhjetë e dy) fishekët objekt ekspertimi janë fishekë të fabrikuar armegjahu kalibër 12, të rregullt teknikisht dhe realizojnë qitjen ***** 4 (katër) copëfishekë objekt ekspertimi u përkasin fishekëve të kalibrit 9x19mm që përdorensi municion për pistoletat Beretta, Glock, Parabel etj, si dhe automatikët ekëtij kalibri si MP5, Beretta, MP40, MP 41 etj***** Ato janë të rregullt teknikishtdhe realizojnë qitjen ******

Ështëmarrë vendim për kryerjen e ekspertimit daktiloskopik për 1(një) kaske helmetee 1 (një) maskë silikoni***** Nga akt ekspertim vlerësues i provave materiale Nr*****11971 datë 22*****12*****2023 është konkluduar se në objektet e ekspertimit fiksuarqatë këqyrjes në vendin e ngjarjes “Fiksim prove” gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e shtetasit ***** Gila, ndodhur me datë 05*****12*****2023 në lagjen “Partizani” Shkodër u përfituan dy gjurmë papilare të emertuara megermat “A”, “B” të vlefshme për identifikim”*****

Ngaakt ekspertim daktiloskopik krahasues nr***** 2327 datë 05*****04*****2024 është konkluduar se gjurmët papilare të pasqyruara në fotografitë me mbishkrimet e germave “A” dhe “B” object ekspertimi të fiksura në vendngjarjen e datës 05*****12*****2023 nëlagjen “Partizani” Shkodër ku gjatë kontrollit të ushtruar në banesën eshtetasit ***** Gila, janë gjetur dhe sekuestruar sende të kundërligjshme, nuk janë formuar nga gishtat eshtetasve Emirson Jonuz Gila e Ergys Jonuz Gila*****

Nga akt ekspertim daktiloskopik krahasuesnr***** 4126 datë 14*****06*****2024 është konkluduar se gjurmët papilare të pasqyruara nëfotografitë me mbishkrimet e germave “A” dhe “B” object ekspertimi të fiksuar në vendngjarjen e datës 05*****12*****2023 në lagjen “Partizani” Shkodër ku gjatëkontrollit të ushtruar në banesën e shtetasit ***** Gila, janë gjetur dhesekuestruar sende të kundërligjshme, nukjanë formuar nga gishtat e shtetasve Fatmir Hasan Faslija dhe ***** JonuzFaslia*****



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër

Është marrë vendim për kryerjen e ekspertimit daktiloskopik për 1(një) imitim mustaqedhe mjekre***** Nga akt ekspertim vlerësues i provave materiale Nr***** 11620 datë 14*****12*****2023 është konkluduar se në objektin e ekspertimit të fiksuar në cilësinë e provës materiale nuk upërfituan gjurmepapilare të vlefshme për identifikim*****

Është marrë vendim për kryerjen e ekspertimit daktiloskopik për 13 pakot e mbeshjtjella me qese plastike, të mbyllura mevakum, në brendesi të të cilit gjendet material i presuar në gjendje të ngurtë***** Nga akt ekspertim vlerësues i provave materiale Nr***** 11621 datë 14*****12*****2023 është konkluduar se në objektin e ekspertimit të fiksuar në cilësinë e provës materiale nuk u përfituan gjurmepapilare të vlefshme për identifikim*****

Është marrë vendim për kryerjen e ekspertimit biologjik për: 2 (dy) palë doreza duarsh, material sintetik, mengjyrë të zezë, 2 (dy) maska kokë, material sintetik, me ngjyrë të zezë, tëhapura tek pjesa e syve, 1 (një) kaskë hekuri (helmetë), si ato të ushtrisë, mengjyrë të zezë, 1 (një) maskë silikonin, në formën e kokës deri tek pjesa e gjoksit, e përshtatshme me ngjyrën elëkurës, 2 (dy) paruke flokësh, njëra me ngjyrë kafe dhe tjetra ngjyrë gri; vendim për kryerjen e ekspertimit daktiloskopik për 1(një) imitim mustaqesh dhëmjekre, me ngjyrë të zezë e 1 (një) maskë silikonin*****

Është administruar akti i ekspertimit nr***** 3435 datë 22*****05*****2024 'Ekspertim biologjik ADN-je', sipas të cilit është konkluduar se:

*"1***** Nga mostra biologjike ekzaminuar me analizën e ADN-së, përgatitur nga mbetjet marrë me tampon në 1(një) maskë silikonin, (provë materiale 1), objekt ekspertimi, u përftua profil gjenetik miks i pavlefshëm për identifikim******

*2***** Nga mostra biologjike ekzaminuar me analizën e ADN-së, përgatitur nga 1 (një) paruke gri e bardhë marka "Hivision", (provë materiale 2), objekt ekspertimi, u përftua profil gjenetik ipjesshëm i pavlefshëm për identifikim******

*3***** Nga mostra biologjike ekzaminuar me analizën e ADN-së, përgatitur nga mbetjet marrë me tampon në 1 (një) paruke kafe marka "Hivision", (provë materiale 3), objekt ekspertimi, u përftua profil gjenetik miks i pjesshëm i pavlefshëm për identifikim*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër

4***** Nga mostra biologjike ekzaminuar me analizën e ADN-st, përgatitur nga mbetjet marrë me tampon në 1 (një) kapuç kokë ngjyrë me rrjetë në pjesën e perparme, (provë material 4), objekt ekspertimi, u përtua profil gjenetik miks ipavlefshëm për identifikim*****

5***** Nga mostra biologjike ekzaminuar me analizën e ADN-së, përgatitur nga mbetjet marrë me tampon në 1 (një) kapuç Kokëngjyrë e zezë i hapur nivelin e syve, (provë materiale 5), objekt ekspertimi, u përtua profil gjenetik miks i pavlefshim për identifikim,

6***** Nga mostra biologjike ekzaminuar me analizën e ADN-st, përgatitur nga mbetjet marrë me tampon në 4 (katër) dorezasintetike, (provë materiale 6), objekt ekspertimi, u përtua profil gjenetikmiks i pa interpretueshëm*****

7***** Nga mostra biologjike ekzaminuar me analizën e ADN-st, përgatitur nga mbetjet marrë me tampon në skafandrën e zezë (provë materiale 7), objekt ekspertimi, **nuk** u përtua asnjë profilgjenetik*****

Është administruar akti i ekspertimit nr*****3679 datë 30*****05*****2024 "Ekspertim biologjik ADN-je", sipas të cilit është konkluduar se: "1***** Nga mostra biologjike ekzaminuar me analizën e ADN-së, përgatitur nga jeleket të vendosur përkatësisht në qeset me nr*****serialunik C3000878, C3000877, C3000873, B3001025, C3000875 dhe C3000874 u përfituan gjashtë profile gjenetikemikes të pjesshëm të pavlefshëm për identifikimi për analizën e AND/së*****

Nga mostra biologjike ekzaminuar me analizën e AND/së, përgatitur nga jeleku me ngjyrë të errët antiplumb/balistiki future në qesen me nr*****serial unik C3000876 u përfitua profil gjenetik miks i vlefshëm për krahasim me analizën e AND-së*****

Në datën 28*****06*****2024 është marrë vendim për kryerjen e ekspertimit biologjik krahasues ADN lidhur me profilet gjenetike të vlefshme për identifikim, të gjetura në vendin e ngjarjes për shtetsait ***** Gila, Emerson Gila, Ergys Gila e Fatmir Faslia*****

Nga akti i ekspertimit nr***** 7671 datë 23*****1*****2024 (administruar në institucion me datë 31*****10*****2024) "Ekspertim biologjik AND krahasues në lidhje me ngjarjen e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër

datës 05*****12*****2023 në lagjen "Partizani" Shkodër është konkluduar se: "1*****
Kampion pështymë marrë me tampon shtetasit ***** Gila është çuar për ekzaminim në
Mbretërinë e Bashkuar në sajë të projektit të përbashkët mes vendit tonë dhe tyre, për
analizimin e të gjithë kampionëve të pështymës për personat arrestuar/ndaluar*****"

2***** Nga mostrae përgatitur për ADN nga kampion pështyme marrë me tampon
shtetasit Ermison Gila, (provë materiale 2), model krahasimi, nuk u përfatuan të dhëna
gjenetike të vlefshme për krahasim*****

3***** Nga mostrae përgatitur për ADN nga kampion pështyme marrë me tampon
shtetasit Ergys Gila, (provë materiale 3), model krahasimi, u përfatuan të dhëna gjenetike të
vlefshme për krahasim, të cilat nuk përfshihen në profilin gjenetik human miks të përfatur nga
jeleku, ekzaminuar me aktin Nr*****3679, datë 30*****05*****2024*****

4***** Nga mostrae përgatitur për ADN nga kampion pështyme marrë me tampon
shtetasit Fatmir Faslija, (provë materiale 4), model krahasimi, u përfatuan të dhëna gjenetike
të vlefshme për krahasim, të cilat nuk përfshihen në profilin gjenetik human miks të përfatur
nga jeleku, ekzaminuar me aktin Nr*****3679, datë 30*****05*****2024*****"

Janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale dy aparate celulare shtetasit ***** Gila,
një model phone 7 Plus dhe një aparat Android, të cilat janë dërguar për ekspertim teknik-
kompjuterik në institutin e policisë shkencore***** Është administruar aktin***** 3272 datë
17*****05*****2024 "Ekspertim kompjuterik aparat celular me kartë SIM", bashkëlidhur CD
me të dhënat e nxjerra nga telefoni i shtetasit ***** Gila, ku nga analizimi në tërësi i aktit nuk
konkludohet për përfshirjen e personave të tjerë në kryerjen e veprës penale*****

Është bërë këqyrja e telefonit të shtetasit ***** Gila, ku në rubriken
instagram konstatohet se ka biseda dhe thirrje të shpeshta me username eg8888, që fillojnë
nga ora 22:06 deri në orën 23:02***** Me rëndësi për këqyrjen është rubrika photos, ku në
foto dallohet një send i ngjashëm me armë zjarripistoletë me mbishkrimin CZ (Cervena
Zastava 99), ndërsa në dy foto të tjerë dallohet kutia e mbajtjes së kësaj arme në gjendje të
hapur dhe të mbyllur***** Këqyrja është shoqëruar me fotografi*****

Është pyetur në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet shtetasi ***** Gila, i cili
nuk ka pranuar të japë deklaratime*****



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër

Është pyetur në cilësinë e personit që kadijeni shtetasi **Ergys Gila** i cili deklaron se punon në ndërtim, kryesisht në Mal të Zi, ku banon në një shtëpi me gruan dhe 4 fëmijet e tij***** Medatë 05*****12*****2023, mbasditë ka ardhur në Komisaratin e Policisë Shkodër për të bërë denoncim në lidhje me bashkëshorten e tij, shtetasen Safete Gila, pasi ajo është larguar në mengjesin e datës 05*****12*****2023 dhe nuk është kthyer në banesë, nuk është përgjigjur në telefon dhe nuk ka dijeni për vendndodhjen e saj***** Aideklaron se ***** Gila është vëllai i tij, por nuk ka dijeni për gjërat egjetura në banesë***** Ai jeton në shtëpi në vete, ndersa vëllai jeton në shtëpingjitur me të tij, së bashku me nënën e babain***** Policia gjithashtu ka ushtruar kontroll edhe në banesën e tij, por nuk ka gjetur gjë të kundralegjshme***** Ipyetur se për çfarë i shërbejnë vëllait sendet e gjetura në banesë, ai deklaron se nuk e di, nuk i ka parë ndonjëherë ato gjëra*****

*Është pyetur shtetasi **Ergys Gila** (vëllai ***** Gila), i cili ka deklaruar se janë katër vellezer dhe Eri Gila është vëllai i tij, i cili merret me rregullimin e kondicionerëve në një biznes privat, por ka ikur disa kohë në Gjermani për operimin e syrit dhe ka ardhur në Shqipëri për t'i takuar, një ose dy ditë pas ngjarjes***** I pyetur nëse njeh një shtetas me emrin Fatmir, ai deklaron se shtetasi me emrin Fatmir është babai inuses, Safetes***** I pyetur nëse i ka takuar njeri në banesë ditën e ngjarjes, aideklaron se ka shkuar kunata për të folur në lidhje me denoncimin dhe nuk ka shkuar askush tjetër në dijeninë e tij***** I pyetur nëse u është afruar këto kohë ndonjë shok i *****it apo ndonjë person tjetër për t'interësuar për të, ai deklaron se nuk ka dijeni se është afruar ndonjë shok tjetër, përveç të afërmeve të tyre të cilët janë interesuar për të***** I pyetur nëse ka kërcënuar bashkëshorten në një moment të caktuar, aideklaron se nuk e ka kërcënuar në asnjë moment bashkëshorten e tij***** I pyetur nëse ka pasur dijeni lidhur me sendet e kundraligjshme të gjetura në banesën e vëllait ***** Gila, ai deklaron se nuk ka dijeni për to***** Ai jeton në shtëpi në vete, ndersa vëllai jeton në shtëpi ngjitur me të tij, së bashku me nënën dhe babain dhe nuk ka pasur dijeni për sendet e kundraligjshme që vëllai ka pasur në banesë***** I pyetur se përse i shërbenin vëllait të tij sendet e gjetura në banesën ai deklaron se nuk i ka parë ndonjëherë ato gjëra***** I pyetur nëse ka parë ndonjë sjellje të çuditshme të vëllait të tij kohët e fundit, ai deklaron se nuk ka parë ndonjë sjellje të çuditshme, më së shumti është në punë dhe nuk ka kohë për asgjë******

*Është pyetur shtetasi **Ermison Gila** (vëllai i ***** Gila) i cili ka deklaruar se momentalisht është i papunë, por më përpara kapunuar si rregullues i kondicionerëve të një biznesi privat që quhet Artan Markudhe jeton në një shtëpi me vëllezërit dhe me familjarët e tij***** I pyetur nëse njeh një shtetas me emrin Eri, ai deklaron se quhet Ermison, ndërsa të gjithë e thonë me shkurtime Eri***** I pyetur se ku ka qenë ditën e ngjarjes pra me datë 05*****12*****2023, ai deklaron se ditën e ngjarjes ka qenë jashtë vendit në Gjermani për të operuar syrin tim pasi ka disa kohë që ka probleme me sytë dhe në Shqipëri ka mbërritur një ditë pas ngjarjes***** I pyetur nëse njeh një shtetas me emrin Fatmir, ai deklaron se Fatmiri është babai i nuses Safetes***** I pyetur nëse ka pasur dijeni për sendet e kundraligjshme të gjetura në dhomën e shtetasit ***** Gila, ai deklaron se nuk ka dijeni për to, pasi ata jetojnë në një banesë, por të ndarë në dhoma dhe nuk ka pasur dijeni se ato sende i kanë pasur në banesë***** I pyetur se kujt i referohet i vëllai juaj kur citon fjalët "na mori në qafë Eri", ai deklaron se se nuk e di se çfarë ka thënë ai, por Eri e thërrasin*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër

shkurt***** I pyetur nëse është përdorues i lëndëve narkotike çokollatë apo cannabis
sativa, ai deklaron se ka qënë përdorues i lëndëve narkotike siajo çokollatë dhe ajo
cannabis sativa***** I pyetur nëse ka ndonjë informacion se ku mund t'i ketë siguruar
*****i sendet, ai deklaron se nuk e di se ku mund t'i ketë marrë*****i këto sende***** I
pyetur se përse i sherbenin vëllait të tij sendet e gjetura në banesë ai deklaron se nuk i ka
parë ndonjëherë ato gjera***** Ipyetur nëse ka parë ndonjë sjellje të çuditshme të vëllait të
tij kohët e fundit, ai deklaron se nuk ka parë ndonjësjellje të çuditshme, më së shumti është
në punë dhe nuk kam kohë për asgjë*****

Është pyetur shtetase **Safete Gila**, e cila ka deklaruar se momentalisht punon në Malin e
Zi dhe jeton nënjë banesë me qira me një vajzë tjetër pasi është larguar që nga data 5
dhjetor2023 nga banesa ku jetonte***** E pyetur nëse e njeh një shtetas me emrin Eri
ajodeklaron se Eri është kunati i saj dhe se quhet Ermison***** E pyetur se me çfarëmerret
Eri, ajo deklaron se është i papunë dhe nuk merret me asgjë***** E pyetur seku ka qënë
ditën e ngjarjes ajo deklaron se ka qënë në Tiranë dhe nga atje kabërë telefonatën Sallës
Operative Shkodër***** E pyetur nëse ka pasur dijeni për sendet e paligjshme që
ndodheshin në banesën e shtetasit ***** Gila, ajodeklaron se nuk ka pasur dijeni për
sendet që mbante *****i***** E pyetur se meçfarë merret bashkëshorti dhe çfarë shoqërie
ka ai, ajo deklaron sebashkëshorti është i papunë, por ka punuar për disa kohë në Gjermani
si punëtorkrahu dhe se nuk ka dijeni në lidhje me shoqërinë e bashkëshortit të saj pasiai nuk
e informonte për asgjë***** E pyetur nëse ka ndonjë informacion se ku mundt'i ketë
siguruar *****i sendet e kundraligjshme ajo deklaron se nuk ka asnjëide dhe se
bashkëshorti i saj nuk ka bërë asnjë sjellje të çuditshme kohëve tëfundit*****

Është pyetur shtetasi **Fatmir Faslija**, i cili ka deklaruar se punon te Bujtina Muriqit, e cila
ndodhet në Tarabosh, jeton në një shtëpi me gruan, vajzen e madhe e cila quhet Eduarta
dhe burrin esaj shtetasin Agim Verri***** I pyetur se çfarë lidhje kenime familjen Gila, ai
deklaron se vajza edytë që quhet Safete, ka kene e martuar me shtetasin Ergys Gila***** I
pyetur nëse e njeh shtetasin ***** Gila, ai deklaron se shtetasin ***** Gila e njeh
vetëmpasi është vëllai i Ergysit, ish burrit të vajzës, me shumë nuk e njeh dhe nukka ndenjur
asnjëherë me të***** I pyetur se çfarë ka bërë ditën e ngjarjes, me
date05*****12*****2023, ai deklaron se atë ditë ka qënë në punë te Bujtina Muriqit*****
Rri tekpuna 24 orë pasi dhe aty jeton dhe në shtëpi shkoj vetëm kur merr rrogën dhe
uadërgon te shtëpia nuses e vajzës***** I pyetur ku ka qënë natë e ngjarjes ajodeklaron se
atë natë që ka shkuar policia, ai ka qënë duke ndenjur tek shtëpia e Jonuzit që është dhe
babi i dhëndrrit të tij Ergysit***** Në shtëpi meJonuzin jeton dhe *****i, pasi Ergysi ka
shtëpinë e vet***** Ka shkuar tekshtëpia e Jonuzit pasi donte të interesohej për vajzën e tij,
sepse i kishin thënë që vajza kishte ikur nga shtëpia dhe nuk dinin gjë se ku kishte shkuar, për
këtë ka shkuar të takonte babain e dhëndrrit Jonuzin për tu sqaruar dhemarrë vesh se çfarë
kishte ndodhur***** Deklaron se nuk ka aspak dijeni për gjërat që janë gjetur në banesën e
*****it, pasi ai nuk ka ndërhyrë kurrë në punët e tyre dhe as i ka pyetur ndonjëherë se çfarë
bëjnë*****

Nëambientet e Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër është realizuar përgjim ambiental
mes shtetasve ***** Gila e Ergys Gila, autorizuar me vendimin e prokurorit, ku rezultojnë se:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër

******* Gila:** *****Ti mos fol gja mor njish, rri i qet, une nuk kam lidhje me vllan, jamne vedi une mor vlla!***** A ndin mor?

Ergys Gila: Po mor po, njashtu i thashe*****

*******i:** Kur te dalesh, ruji femijet, mos i ço ne shkoll një her*****Nuk te majn ty,ti rri i Qet*****Nuk ke pune ti!
*****Ja pava sherrin Erit***** Ty
edheatij*****Ti rri i qet, mos ha provokime hiq!
*****Ça ke hall ti!? Ti me pas njetmendje vlla, mos me ba gabime hiq!
Xero, xero, xero! A more vesht?

Ergysi: Po mor***** Shyqyr burr, qe nuk kan gjet ate*****!

*******i:** Qyyyyshstttt!*****Kan hi edhe
n'bodrum*****Mos e rruj hiq, e hekamakinen!
*****Njita jane ne internet... sido me ken njito jan ne internet, por ashtalli i
hashashit***** Ka 20 paketa çokollata***** Njizet paketa çokullata...!
*****Ti rrii qet*****!

Ergysi: Po per çifte, ça te thane?*****

*******i:** A more vesht, hiq, xero me mu, nuk ke pune, jam n'shpi n'vedi!

Ergysi: Pa*****Ç'far rriskut qe se zune ate
t'temen*****

*******i:** Shshshshshshet*****



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër

Ergysi: Pa pas pula me ba ish*****

*******i:** Rri i qet, pa hanger nuk ju lajn*****

Ergysi: Jam tuj vra vedin mor shok!

*******i:** Pse mor me vra vedin, nuk ke shans mor, leni marrinat!?Mos u ban i marr! Ke kater fmi***** shndet, kaq!***** Ti me ndejt urt, n'punetande, njaty te shpija e

Ergysi: Ti n'telefon nuk ke pas gja!?***** *****

*******i:** Ja mor nuk kam pas gja, s'kam fol gja*****Shyqyr qe e shina do fotoPistoletet CC-se***** Desht me e gjet ai bossi!*****Thashe tesh pa e gjen!!*****E hekase e pata me vedi!*****Dy minuta pa ardh ju, dy minuta robt!*****Mas dy minutash mekishin zan njaty robt!***** Ma gjeten kutin e me thane ku e ke?*****Eeee ku e kam?!Nuk kam gja i thash! *****Tesh pa me nxjerin pune per çifte! A kupton!? *****Njizetçokolata! Abababa*****

*******i:** Kam hallin e çiftes *****N'qoft se asht me leje del ajo*****Po ai me ka lanmaskat aty mor! Puaaaaaaaaaa! Ça ju pava sherrin ty e atij*****! Perantiplumat blihen ne internet, por baj burg per hashash e çokolata robtemotrat!***** Yyyyy, njizet pakata mor! Obobobobobobo! Edhe per çifte*****

Në përfundimin e hetimeve paraprakeprokuroria ka ngritur akuzë ndaj të pandehurit Gila për kryerjen e veprë penale të paraparë nga neni 283/1 i KP, për shkak se vetëm për këtë akuzë ka patur prova të mjaftueshme*****Në seancë paraprake ky qëndrim u gjet i drejtë nga gjykata, duke u vlerësuar sehetimet paraprake paraqiten të plota, cilësimi juridik i veprës penale i saktë,provat në mbështetje të akuzës së ngritur të mjaftueshme etj, me ç'rast



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër

upranua kërkesa për gjykimin në themel të çështjes, natyrisht me ritin egjykimit të shkurtuar***** Ndjekja penale për veprat e tjera penale në ngarkim të të pandehurit Gila, për të cilat është regjistruar procedimi penal, është amnistuar sipas ligjit të posaçëm*****

Përveç sa është treguar më sipër në këtë vendim, faktet dherrethanat e çështjes provohen edhe me të gjitha aktet e tjera të dosjes së procedimit penal nr*****1506/2023, të administruara në fashikullin e gjykimit*****

3***** Vlerësimi gjykatës*****

Për të zgjidhur drejt themelin ekërkimeve të organit të prokurorisë sa i takon përgjegjësisë penale të të pandehurit ***** për sa akuzohet, gjykata çmon t'i referohet nenit 283 të KP***** Kjo dispozitë e KP, e titulluar **“Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”**, parashehë:

*“Shitja, ofrimi për shitje, dhënia ose marrja në çdo formë, shpërndarja, tregtimi, transportimi, dërgimi, dorëzimi, si dhembajtja, përveç rastit të përdorimit vetjak dhe në doza të vogla, të substancave narkotike dhe psikotrope, si edhe i farërave të bimëve narkotike, nëkundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tyre, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet******

*Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet******

*Organizimi, drejtimi apo financimi i kësaj veprimtarie, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet*****”*

Objekti i veprës penale **“Prodhimi dhe Shitja e Narkotikëve”** të parashikuar nga neni 283 paragrafi i parë i KP mund të identifikohet si i dyfishtë në objekt parësor dhe në objekt



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër

dytësor***** Objekti parësor janë marrëdhëniet juridike që garantojnë shpërndarjen, blerjen, shpërndarjen transportimin, mbajtjen dhe përdorimin sipas dispozitave ligjore përkatëse të lëndëve narkotike e psikotrope, nga veprime të kundërta ligjshme e shoqërisht të rrezikshme, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në shëndetin e personit, funksionimin normal të veprimtarisë së organeve jetësore të tij***** Kjo dispozitë përjashton nga përgjegjësia personale përdoruesit elëndëve narkotike duke përcaktuar si kritere mbajtjen në doza të vogla, ndërsapërgjigjen penalisht pavarësisht se është përdorim vetjak kur sasia e mbajtur është e madhe***** Qëllimi i ligjvënësit në përjashtimin e përdoruesve ka qenë duke i parë ata si viktimë të veprës penale dhe jo si subjekte të kryerjes së saj***** [1] Ndërsa objekti dytësor i kësaj vepre penale janë marrëdhëniet juridike të vendosura nga ligji për të garantuar paprekshmërinë e rendit dhe qetësisë publike, jetës dhe shëndetit të njeriut***** Kjo tërësi marrëdhënies juridike dhe jo vetëm janë të mirat publike dhe të të mbarë shoqërisë që justifikojnë dhe përligjin ekzistencën e legjislacionit penal*****

Nga ana objektive, vepra penale e prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, parashikuar nga neni 283 i KPP-së duhet që i pandehuri, subjekti aktiv i saj, të kryejë njërën prej veprimeve aktive që dispozita e mësipërme liston në mënyrë kufizuese dhe të mbyllur***** Këto s'janë gjë tjetër veçse figurat konkrete të veprës penale mëmë që është "Prodhimi dhe Shitja e Narkotikëve"***** Për shembull, ai duhet t'a shesë atë***** **Shitja**, në rastin konkret, është dhënia e lëndës narkotike, të substancave narkotike, lëndëve psikotrope apo i farërave të bimëve narkotike një tjetri kundrejt çmimit, të çfarëdo sasive qoftë por e kufizuar kjo në një veprim konkret apo eshëmta në disa veprime pa një lidhje të qëndrueshme, pa një mendim unik evazhduesh kriminal, e me frekuenca jo të rregullta të ndodhjes së saj***** Përqëllime të ligjit do të mjaftonte një transaksion i tillë për ta quajtur të konsumuar këtë figurë të veprës penale***** Shitja si koncept juridik edhe mund të huazohet nga e drejta civile, për t'u kuptuar si natyrë veprimi juridik në këtë rast, por nuk do të mund të shkonte logjika referuese më tej, pasi, sigurisht, që në rastin konkret flasim për një veprim absolutisht të pavlefshëm, pasqendri i kontraktuar ndalohej të qarkullojë civilisht dhe si i tillë veprimi juridik ndalohej nga ligji***** Një variant tjetër i konsumimit të kësaj vepre penale është ofrimi për shitje***** **Ofrimi për shitje** është shfaqja e vullnetit në mënyrë të padyshimtë të poseduesit të lëndës narkotike, substancave narkotike, lëndëve psikotrope apo farërave të bimëve narkotikëdujt për ta shitur atë***** Kjo figurë vepre penale dhe kjo shfaqje e vullnetit mund të ndodhë me çdo veprim të mundshëm komunikimi, qoftë edhe me veprimet konkludente***** Vetëm shfaqja e vullnetit të poseduesit të lëndës ligjërisht të ndaluar do të jetë e nevojshme dhe e domosdoshme për të patur këtë figurë vepre penale***** **Dhënia ose marrja në çdo formë** si figurë konkrete e veprës penale mëmë synon të përfshijë të gjitha llojet e veprimeve që kalojnë në posedimin e lëndës narkotike, substancave narkotike, lëndëve psikotrope apo farërave të bimëve narkotike, të pa përfshira në dispozitë, p*****sh***** shkëmbimi, dhurimi etj***** Edhe në këtë rast do të jemi në të njëjtën logjikë juridike të rastëve të mësipërme, që do të thotë se veprimi kriminal konkret ndodh një herë apo edhe disa herë por pa u bërë qëllim në vetvete dhe mjaftueshëm i shkëputur në kohë sa për të mos u ravigjzuar si veprimtari e vazhdueshme apo e qëndrueshme kriminale***** **Transportimi** si një prej figurave konkrete konsumohet duke u realizuar zhvendosja e lëndës narkotike nga një vend në një vend tjetër pa qenë nevoja për veprime të tjera***** **Dërgimi** është figurë mjaft e ngjashme me transportimin e lëndës narkotike veçse karakterizohet nga një intensitet më i ulët fizik i zhvendosjes së saj***** Dërgimi është një formë endërmjetme midis transportimit dhe dorëzimit si figura të veçanta kriminale***** **Dorëzimi** është veprimi fizik i lënies së lëndës narkotike, substancave narkotike, lëndëve psikotrope apo farërave të bimëve narkotike në destinacionin e porositur***** **Mbajtja** si figurë konkrete kriminale është posedimi i qëndrueshëm dhe latent i lëndës narkotike, substancave narkotike, lëndëve psikotrope apo farërave të bimëve



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër

narkotike nga një subjekt në vende të caktuara për këtë qëllim, me qëllim për ta ofruar, shpërndarë, transportuar, dorëzuar, dërguar, tregtuar apo për ta dhënë në çdo formë kundrejt një subjekti tjetër***** Megjithatë qëllimi nuk është i shprehur në dispozitë, Gjykata çmon se vetëm në të tillë mënyrë interpretimi kjo figurë konkrete e veprës penale shfaq veprimtari që karakterizohet nga rrezikshmëria shoqërore***** Megjithatë Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë pranuar se kjo figurë veprë penale mund të quhet ekonsumuar edhe pa u vërtetuar qëllimi si element i anës subjektive***** Të katërtakëto figura të mësipërme kanë një gjë të përbashkët, faktin se këto forma objektive kriminale janë një pjesë e aktivitetit kriminal të trafikimit apo tregtimit të lëndës narkotike, janë hallka të ndërmjetme të një veprimtarie kriminale tërësore***** Në këto kushte, pavarësisht aftësisë zbuluese dhe procedurave të organeve të ndjekjes penale të shtetit, këto vepra penale gjithmonë kryhen në bashkëpunim, pasi janë pjesë e një veprimtarie të tërë***** Përtë vazhduar më tej me figurat konkrete, njëra prej tyre është shpërndarja***** **Shpërndarja** është tërësia e veprimeve fizike transportuese, dërguese, dorëzuese apo dhënie në çdo formë, në mënyrë të përsëritur të lëndës narkotike, substancave narkotike, lëndëve psikotrope apo farërave të bimëve narkotike në një apo disa pika të ndryshme***** Ajo presupozon një shtrirje të qëndrueshme dhe të vazhdueshmenë kohë të veprimeve të përmendura më sipër dhe për këtë arsye përbën krimlatent apo vazhdues, pasi ndodh në boshtin e të njëjtit mendim unik kriminal***** **Tregtimi** i lëndës narkotike, substancave narkotike, lëndëve psikotrope apo farërave të bimëve narkotike, si figurë konkrete e veprës penale presupozon krijimin e një veprimtarie tregtare të subjektit aktiv të veprës penale me këto lëndë***** Kryerja e shitjeve, shkëmbimeve apo e çdo veprimi tjetër me karakter tregtar, apo e çdo lloji transaksioni të mundshëm që sjell përfitime pasurore dhe që synon të kalojë posedimin e lëndës së ndaluar ligjërisht, e shtrirë në kohë në mënyrë të vazhdueshme dhe të qëndrueshme nën një mendim unik kriminal do të përbëntë figurën e veprës penale të posaçme të tregtimit***** Natyra e dy figurave të veprës penale të sqaruara së fundmi është e përbashkët dhe njëkohësisht dallon nga figurat e renditura jo pa qëllim më sipër për nga karakteri sporadik i ndodhjes dhe i lidhjes midis tyre***** Dy figurat e fundit të veprës penale sigurisht që paraqesin rrezikshmëri shoqërore më të lartë se sa të parat për të gjitha arsyet e sqaruara më sipër*****

Neni 283 paragrafi parë i KP është një dispozitë blankete apo e bardhë dhe si e tillë për t'u bërë e zbatueshme kërkon domosdo ekzistencë e një ligji tjetër të cilës do t'i referohet rast pas rasti***** Legjislacioni shqiptar përmban rregullime të posaçme për sa i përket çdo lloji veprimtarie që lidhet me substancat narkotike dhe lëndët psikotrope***** Ndërmjet të tjerave, mund të evidentohen ligji nr*****7975, datë 26*****7*****1995 "**Përbarnat narkotike dhe lëndët psikotrope**" (i ndryshuar) dhe ligji nr*****8874, datë 29*****3*****2002 "**Për kontrollin e lëndëve që përdoren për fabrikimin e paligjshëm të lëndëve narkotike dhe psikotrope**"***** Këto ligje, si dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë e për zbatim të tyre, parashikojnë rregulla të qarta për kushtet, kriteret dhe procedurat, teknikat e ligjore, përlejimin, autorizimin dhe disiplinimin e veprimtarive për prodhimin, fabrikimin, tregtimin, shpërndarjen me shumicë dhe pakicë, transportimin, furnizimin, dhënien kundrejt pagesës ose falas, blerjen, importimin, eksportimin, kalimin tranzit, vënien në përdorim e mbajtjen për qëllime mjekësore, studimore, shkencore ose për qëllime të tjera industriale apo në të tjera veprimtari, të atyre substancave narkotike dhe lëndëve psikotrope që nuk janë të ndaluara për t'u qarkulluar***** Këto veprimtari mund të ushtrohen vetëm nga subjekte të autorizuar posaçërisht për këtë qëllim sipas ligjit nga autoritetet kompetente***** Prandaj, në kuptim të nenit 283 të KP, me shprehjen "**në kundërshtim me ligjin**", përfshihet: **së pari** kryerja e veprimeve a veprimtarive me substanca narkotike e psikotrope nga ato që janë të ndaluara me ligj për t'u vënë në qarkullim; **së dyti**, kryerja e veprimeve e veprimtarive me substanca të tillatë lejueshme për qarkullim por për



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër

qëllime jashtë atyre të parashikuara e tëlejuara nga ligji***** **së treti**, kryerja e veprimtarive me substanca të tilla të lejueshme për qarkullim por pa qenë ipajisur me autorizimet përkatëse apo në shkelje e kapërcim të kushteve tëparashikuara në autorizim, të cilat kualifikohen si veprime a mosveprime tëatilla që përbëjnë vepër penale e jo më shkelje administrative*****[2]

Gjykata çmon të theksojë se, krimi i prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike që parashikohet në nenin 283 të KP, përveç shitjes, ofrimit për shitje, marrjes në çdo formë, shpërndarjes, tregtimit, transportimit, dërgimit dhe dorëzimit të substancave narkotike dhe psikotrope, si dhe i farërave të bimëve narkotike, në kundërshtim me ligjin osenë kapërcim të përmbajtjes së tyre, nga ana objektive, kryhet edhe në formën embajtjes së këtyre lëndëve, substancave e farërave, në kundërshtim me ligjinose në kapërcim të përmbajtjes së tyre***** Lidhurme këtë formë (mbajtjen) të anës objektive të kësaj figure krimi, Ligjvënësi, si kriter përcaktues për ekzistencën e vetë figurës së krimit dhe, për pasojë, të bazës së përgjegjësisë penale për personat që e konsumojnë atë, kaparashikuar dy rrethana specifike: **së pari**, mbajtjen e substancave narkotikedhe psikotrope, si dhe të farave të bimëve narkotike jo për përdorim vetiak dhe **së dyti**, edhe kur rezulton i provuar fakti që, këto lëndë mbahen ngapersoni për përdorim vetiak, në aspektin sasior, ato nuk duhet të jenë në dozatë vogla***** Përsa i përket rrethanës së parë, Gjykata vë në dukje se ajo është rrethanë fakti - rezultat i procesit të të provuarit nëpërmjet analizës, nëzbatim të kërkesave të dispozitës së nenit 152 të Kodit të Procedurës Penale, të provave dhe indicieve, në të cilat duhet të bazohet gjykata për të arritur në përfundime të drejta, nëse lënda narkotike dhe psikotrope, etj***** mbahet ngapersoni për përdorim vetjak apo për të kryer në vijim, ndonjërin apo disa ngaveprimet e tjera të përmendura në dispozitë, që janë elementë të anës objektivetë figurës së krimit të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve***** Theksojmë se, eveçanta e rrethanës **“përdorimi vetjak”** është se ajo nuk qëndron më vete***** Ajo nuk mund të shërbejë e vetme për të arritur në përfundiminse, duke u bazuar vetëm në ekzistencën e saj nuk ekziston edhe figura e krimit të parashikuar në nenin 283 të KP***** Kësisoj, ajo nuk mund të shërbejë e vetmepër të arritur në përfundimin se nuk ekziston baza ligjore (figura e krimit)për të marrë mbajtësin e tyre në përgjegjësi penale***** Përkundrazi, për të mos u marrë mbajtësi i lëndëvetë tilla në përgjegjësi penale duhet të provohet se ekziston edhe rrethana edytë, që ka lidhje me sasinë e këtyre lëndëve, e cila, sikurse shprehel ligjvënësi në vetë dispozitën e përmendur, duhet të jetë **“në doza të vogla”******* Nocioni juridiko-penal që është shprehur nga ligjvënësi me togfjalëshin **“në doza të vogla”**, edhe pse nuk mund të bëhet ndonjë përcaktim numerik i sasisë së lëndëve të ndaluara që do të shprehte në peshë sasinë e dozës për t’u konsideruar e vogël, duhet të interpretohet në kuptimin që, në aspektin sasior, lënda narkotike dhe psikotrope, etj***** , duhet të jetë në atë masë sa të konsiderohet realisht e vogël për përdorim vetjak nga ana e individit konkret dhe jo në përgjithësi***** Ajo nuk duhet të tejkalojë aftësitë fiziko-biologjike të individit përdorues dhe brendakufijve të tolerancës që paraqet organizmi i tij për llojin konkret të lëndës narkotike, në momentin dhe kushtet e përdorimit të kësaj lënde, për të moskrijuar tek ai efekte tej asaj shkalle që do t’i dëmtonin shëndetin***** Kështu, **doza e vogël, në kuptimin ligjor të saj, konsiderohet jo ndarja fizike në disa tëtilla, por sasia e lëndës apo substancës narkotike e psikotrope që ajo përmbansi e tërë dhe që sipas ekspertëve vlerësohet si dozë e vogël******* Gjykata çmon se, përcaktim i tillë i nocionit **“në doza të vogla”**, për efekte të zbatimit të dispozitës së nenit 283 të KP, veç rolit parandalues që luan për ruajtjen e shëndetit të përdoruesve dhe personave që kanë vartësi nga droga, luan dhe rolin e parandalimit të përgjithshëm në drejtim të luftës kundër fenomenit të përdorimit të kundraligjshëm të këtyre lëndëve, i cili ku gjen përhapje në përmasa të mëdha, shndërrohet në patologji sociale***** Në kushtet kur tek ne ende nuk janë përcaktuar, me ligj të posaçëm apo me akte nënligjore, rastet e përdorimit të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër

lëndëvenarkotike dhe psikotrope “*në përputhje me ligjin dhe jo në kapërcim të tyre*”, përcaktimi si më sipër i nocionit juridiko-penal “*në doza të vogla*” shërben edhe për ngushtimin, në një masë të arsyeshme, të hapësirave, shfrytëzimi i të cilave, në formë të padrejta, nga keqbërësit, do të ndikonte në shmangien pa të drejtë nga përgjegjësia penale të përdoruesve të lëndëvenarkotike dhe psikotrope, të cilët shpesh konstatohet se janë edhe shpërndarës të këtyre lëndëve***** Për shkak të njohurive të posaçme që kërkohen në fushën etoksikologjike, gjykata për zgjidhjen e çështjes që lidhet me sasinë e lëndës narkotike të nevojshme për përdorim vetjak duhet të thërrasë në çdo rast specialistë të fushës, si toksikologë apo mjekë terapistë, mendimi shkencor i të cilëve do të shërbejë si njëri prej kriterëve ku ajo do të mbështetë arsyetimin e vendimit të saj***** Por, për zgjidhjen përfundimtare të çështjes, gjykata duhet të mbështetet edhe në kriterin tjetër, me të cilin lidhet ngushtësisht ai i pari, kriter ky, që konkretizohet nëpërmjet sqarimit të rrethanave faktike të mbajtjes së sasisë konkrete të lëndës narkotike apo psikotrope nga personi konkret, nëpërmjet zbatimit të kërkesave ligjore të KPP që vlejnë për realizimin me sukses të procesit të të provuarit, në përgjithësi***** [3]

• Lidhur me akuzën*****

Gjykata, nisur nga faktet materiale të çështjes të provuara në gjykim, bazuar kornizën ligjore të prezantuar më sipër, vlerëson se fajësia e të pandehurit ***** Gila, përkryerjen e veprës penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, parashikuar nga neni 283, paragrafi i parë i KP, provohet tej çdo dyshim të arsyeshëm***** Akuza e ngritur ndaj të pandehurit është e bazuar në ligjin material penal e në provat e fashikullit të gjykimit***** Elementët objektivë e subjektivë të figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 283/1 i KP, të marra në unitet me tyre, plotësohen në rastin konkret dhe i pandehuri ***** Gila duhet të mbahet penalisht përgjegjës për sa akuzohet***** Këto përfundime, përkëto arsye:

Nga aktet e fashikullit gjyqësor provohet se i pandehuri ***** Gila e ka kryer veprimet të drejtpërdrejta për sigurimin dhe mbajtjen e lëndës narkotike***** Sasia e lëndës narkotike të gjetur dhe më pas sekuestruar që shtetasi ***** Gila mban në banesë është në masën 1 (një) kg e 325 (treqind e njëzet e pesë) gram *resin produkt bime cannabis sativa L* (akt ekspertimit kimik nr ***** 12015, datë 26 ***** 12 ***** 2023) dhe 44 ***** 31



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër

(katërdhjetë e katër pikë tridhjetë e një) gram lëndëcannabis sativa L (akt ekspertimit nr*****12052, datë 26*****12*****2023)***** I pandehuri ***** Gila ka vepruar nëkundërshtim me parashikimet ligjore që rregullojnë regjimin juridik të lëndëvenarkotike, substancave narkotike, lëndëve psikotrope apo farërave të bimëve narkotike, konkretisht të ligjit nr*****7975të datës 26*****07*****1995 “*Përbarnat narkotike dhe lëndët psikotrope*”, i ndryshuar, pasi nuk ka qenëligjërish i autorizuar për kryerjen veprimtarisë së mbajtjes me qëllim shitje të lëndës narkotike në një nga formate parashikuara nga neni 283 të KP*****

Nga një analizë e kryqëzuar të dhënaveindiciare dhe e akteve të grumbulluara pjesë e dosjes hetimore, provohet tejçdo dyshimi të arsyeshëm, se i pandehuri ***** Gila, duke mbajtur në banesë lëndë të dyshuar narkotiketë llojit cannabis sativa, ka cënuar marrëdhënietjuridike që garantojnë shitjen, blerjen, shpërndarjen transportimin, mbajtjen dhe përdorimin sipas dispozitaveligjore përkatëse të lëndëve narkotike e psikotrope, nga veprime tëkundërligjshme e shoqërisht të rrezikshme, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt nëshëndetin e personit, funksionimin normal të veprimtarisë së organeve jetësoretë tij***** Krimi i prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike që parashikohet nënenin 283 të KP, nga ana objektive kryhet nepermjet shitjes, ofrimit përshitje, marrjes në çdo formë, shpërndarjes, tregtimit, transportimit, dërgimit, dorëzimit, si dhe mbajtjes të substancave narkotike dhe psikotrope, si dhe ifarërave të bimëve narkotike, në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim tëpërmbajtjes së tyre*****

Të dhënat provuese që përftohen ngadeklarimet e palëve, kqyrja e vendit të ngjarjes, sendet provë materiale, sidhe ekspertimet shkencore, janë të sakta, të rëndësishme dhe njëdrejtimshe***** Tëinterpretuara në raport me njëra-tjetrën dhe në mënyrë të kryqëzuar, këto të dhënatë çojnë në përfundimin e padyshimtë për sa akuzohet ***** Gila*****

Ngaleximi i veprimeve të të pandehurit Gila, në kohë e në hapësirë, konkludojmë seai e ka kryer krimin e prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, parashikuar nga neni 283, paragrafi i parë i KP, me dashje direkte***** I pandehuri ***** Gila është penalisht i përgjegjshëm, i vetëdijshëm për veprimete tij, ai e kupton karakterin e kundërligjshëm dhe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër

shoqërisht të rrezikshëm tësjelljes së tij dhe me koshiencë të plotë ka mbajtur në banesë lëndë tëdyshuar narkotike të llojit cannabis sativa, dukecënuar kësisoj marrëdhëniet juridike që garantojnë shitjen, blerjen,shpërndarjen transportimin, mbajtjen dhe përdorimin sipas dispozitave ligjore përkatësetë lëndëve narkotike e psikotrope, nga veprime të kundërligjshme e shoqërisht të rrezikshme, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në shëndetin e personit,funksionimin normal të veprimtarisë së organeve jetësore të tij*****

Faktet e ngjara provojnë anën subjektivitetë figurës së krimit të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, parashikuar nga neni 283, paragrafi i parë i KP, zbulojnë mendjenfajtores të të pandehurit ***** Gila, për sa akuzohet*****

- Lidhur me caktimin e dënimit*****

Njëherë përcaktuar fajësia e të pandehurit ***** Gila për sa akuzohet, shtrohet për zgjidhje dënimi kryesor qëduhet të caktohet për këtë person: lloji dhe masa e dënimit***** Kriteret dhe parimet themelore që duhet të zbatohet gjykata në caktimin e një dënimi të caktuar janë të përcaktuar në mënyrë të përgjithshme, në nenin 47 të KP***** Konkretisht, në këtë dispozitë penale materiale, sanksionohet se: *“Gjykatat cakton dënimin duke respektuar dispozitat e pjesës së përgjithshme të këtij kodit dhe kufijtë e dënimeve të parashikuar në ligj për veprën penale***** Në caktimin e dënimit ndaj personit ajo merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dherënduese”******

Në vështrim të këtyre kriterëve të caktimit të dënimit, në respektim të parimit të individualizimit të dënimit, gjykata vlerëson se ndaj pandehurit ***** Gila duhet të caktohet dënim prej 5 (pesë) vjet burgim për kryerjen e veprës penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, në bazë të nenit 283/1 të KP***** Dënim penal caktohet duke konsideruar:

- llojin dhe kufijtë e dënimit të parashikuar në dispozitën ligjore konkrete; referimi në dispozitën ligjore konkrete të pjesës së posaçme të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër

KP, është hapi parë që duhet të marrë në vlerësim gjykata, para se të procedojë me vlerësimin e elementëve të tjerë në lidhje me individualizimin e dënimit brendakufijve të parashikuara nga këto dispozita; në rastin konkret, vepra penale eparashikuar nga neni 283/1 i KP përbën krim dhe dënohet me burgim nga pese" gjer në" dhjetë" vjet;

- **rrezikshmërinë e veprëspenale;** rrezikshmëria shoqërore e veprës penale përcaktohet në kuadrin e objektit të saj, nga tërësia e elementëve objektivë dhe subjektivë që e formojnë; neni 283/1 i KP përcakton veprën penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve; vepra penale përbën krim, ligjvënësi parashikon dënimin me burgim në maksimumderi në 10 vjet dhe ajo, pavarësisht faktit se është një vepër penale formale, domethënë që nuk kërkon ardhjen e ndonjë pasoje materiale për efekt të përgjegjësisë penale, paraqet rrezikshmëri shoqërore, pasi cenohet rendi dhe siguria publike; çmohet gjithashtu se kjo vepër penale ka marrë një përhapjeshumë të gjerë në komunitet; prandaj, në caktimin e dënimit, gjykata mban parasysh funksionin e parandalimit të përgjithshëm në kryerjen e kësaj veprëspenale;
- **rrezikshmërinë e autorit;** për të përcaktuar rrezikshmërinë e autorit të veprës penale, bazohemi në radhë të parë në principin që autori i një veprë penale është aq irrezikshëm, sa ç'është e rrezikshme vepra penale që ai provohet se ka kryer; përmë tepër, merren parasysh rrethanat të tjera si: gjendja sociale; profesioni; arsimimi; gjendja familjare; gjendja gjyqësore; të gjithë këta tregues objektivë dhe subjektivë që kanë lidhje të drejtëpëdrejtë me personalitetin dhe individualitetin që paraqet individi në shoqëri, të interpretuar me njëri tjetrin japin konkluzionin se i pandehuri paraqet rrezikshmëri shoqërore të ulët ose të lartë; prandaj, për gjykatën lind detyrimi që në çdo çështje të analizojë faktorët apotiparet e personalitetit të autorit të veprës penale; kjo, për faktin, pasi përarritjen e qëllimit të parandalimit të posaçëm është e nevojshme që dënimi t'i përshtatet personalitetit të fajtorit, domethënë t'i përshtatet tërësisë së karakteristikave individuale të tij; **në lidhje me këtë kriter**, për të pandehurin ***** Gila mbahet parasysh: personaliteti i të pandehurit; mosha etij në momentin e kryerjes së veprës penale (26 vjeç); fakti që është ipadënuar më parë; gjendja e tij familjare (fakti që është beqar dhe jeton me prindërit); specifikohet këtu nevoja që ka babai i tij dhe vëllai i tij për kujdes shëndetësor, referuar dokumentacionit shëndetësor të paraqitur në gjykim); fakti se është me arsim të mesëm;
- **shkallën e fajit;** nga tërësia e të gjithë veprimeve të të pandehurit që



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër

çuan nëkryerjen e kësaj vepre penale, gjykata thekson se ajo është kryer në formën edashjes direkte;

- **rrethanat rënduese**; në lidhje me këtë element, gjykata konstaton se në rastin konkret nuk ekzistojnë rrethana rënduese të parashikuara nga neni 50 i KP;
- **rrethanat lehtësuese**; për sa i përket ekzistencës së rrethanave lehtësuese, gjykatavëren se në rastin konkret, në kuptim të neneve 48 dhe 49 të KP ekzistojnë disarrethana lehtësuese; i pandehuri ka shfaqur pendesë dhe ka pranuar fajësinë përkryerjen e veprës penale para gjykatës; I pandehuri nuk rezulton të jetë recidivist***** I pandehuri është beqar dhe kujdeset për familjarët e sëmurë (babain, vëllain); I pandehuri është në një moshë relativisht të re*****

Gjykata thekson sekjo masë dënimi, është një masë e përshtatshme për të pandehurin ***** Gila, në përputhje me veçoritë e tij dhe të veprës penale konkrete, si dhe me rrethanat në të cilat vepra penale është kryer***** Ndër të tjera, përcaktuese për caktimin e dënimit prej 5 vjet burgim për veprën penale të paraparë nga neni 283/1 i KP, pra në minimumin që parashikondispozita penale, është personaliteti i të pandehurit, gjendja e tij familjare/ekonomike, si dhe fakti që është i padënuar më parë (pra, rezulton se rasti për të cilin procedohet është një rast i izoluar)***** Këto rrethana peshojnë fort për të mos caktuar për të pandehurin Gila një dënim më të rëndë se minimumi i parashikuar nga ligji***** Nëpërmjet dënimit penal të caktuar ndaj të pandehurit synohet ruajtja e një raporti të drejtë mes ndëshkimit të fajtorit dhe mbrojtjes së shoqërisë***** Gjithashtu, gjykata në caktimin e një masë të tillë dënimi ndaj të pandehurit mban parasysh edhe parimin se ashpërsia e një penaliteti për një vepër penale të kryer, duhet të jetë e arsyeshme dhe proporcionale me ashpërsinë e veprës penale*****

Në zbatim të nenit 406, pika 1 të KPP, dënimi i vetëm me burgim prej 5 (pesë) vjet ulet me 1/3 e tij, duke u dënuar përfundimisht i pandehuri ***** Gila me 3 (tre) vjet e 4 (katër) muaj burgim***** Ky është një përfitim ligjor për të pandehurin, që vjen si rezultat i procedimit me gjykim të shkurtuar konform neneve 405 e 406 të KPP, sipas kërkesës së vetë të pandehurit*****

Mbrojtja kërkoi aplikimin edënimit alternativ sipas nenit 59 të KP***** Gjykata e pranon këtë kërkesë si të mbështetur në prova e ligj***** Në nenin 59 të KP, titulluar **“Pezullimii ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë”**, parashikohet shprehimisht se: *“Për shkak të rrezikshmërisë së paktë të personit, moshës, kushteve*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër

shëndetësore apo mendore, mënyrës së jetesës dhe të nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanave të kryerjes së veprës penale, si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale, gjykata, kur jep dënim me burg deri në pesë vjet, mund të urdhërojë, që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin eprovës dhe të vihet në provë, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë veprë tjetër penale”

Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se, kjo alternativë e dënimit me burgim zbatohet nga gjykata kur plotësohen në mënyrë kumulative dy kushte: (i) në përfundim të shqyrtimit gjyqësor çmohet nga gjykata se ipandehuri duhet të dënohet jo më shumë se pesë vjet burgim; (ii) gjatë shqyrtimit gjyqësor rezulton se ekziston një nga rrethanat në vijim: i pandehuri paraqet rrezikshmëri të pakët shoqërore; i pandehuri është i mitur apo i moshuar; i pandehuri ka kushtemendore apo shëndetësore të veçanta; i pandehuri ka detyrime për punën, arsimimin, kualifikimin ose aftësimin profesional; i pandehuri ka përgjegjësitelbësore për familje; i pandehuri e ka kryer veprën penale në kushtet e disarrethanave lehtësuese; i pandehuri ka pasur një sjellje shumë të mirë paskryerjes së veprës penale***** Nga formulimi i nenit 59 të KP rezulton se këtorrethana janë të pavarura nga njëra-tjetra*****

Në rastin konkret, gjykata vlerëson se i pandehuri ***** Gila i plotëson kushtet për pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënien e saj në provë***** I pandehuri u dënua me burgim me një masë dënimi më pak se 5 (pesë) vjet, gjegjësisht me 3 (tre) vjet e 4 (katër) muaj burgim***** Ky kriter formalo-juridik plotësohet***** Për më tepër, nisur nga personaliteti i të pandehurit, gjendja dhe nevojat e tij familjare/ekonomike, si dhe fakti që është i padënuarmë parë (pra, rezulton se rasti për të cilin procedohet është një rast izoluar), konkludohet se është e mundur që të zbatohet alternativa e dënimit me burgim e paraparë nga neni 59 i KP*****

Në këtë kuadër, për të vërtetuar nevojat e jetës familjare, të gjendjes shëndetësore të anëtarëve të familjes së të pandehurit, u paraqitën:

epikrizë e pacientit Jonuz Gila (babai i të pandehurit ***** Gila, që janë pjesë e të njëjtës familje sipas akteve të gjendjes civile të administruara në dosje dhe që jetojnë bashkë në njëbanesë) lëshuar nga dr***** Hava Bushati, Qendra Shëndetësore nr*****3; sipas epikrizës, referuar kartelës shëndetësore nr*****688 lëshuar nga dr***** Hava Bushati, Jonuz Gilavuan nga sëmundje kronike (HTA st II, Diabet Miellitus, Post aksident Cerebro-Vaskular, Hemiplegji dextra)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër

dhe kurohet qysh prej vitit 2017; pacienti Jonuz Gila lëviz me karrocë me rrota, qëndron në regjim shtrati dhe gjendja etij ka ardhur duke u përkeqësuar;

*vërtetim i Komisionit Mjekësor të Përcaktimit të Verbërisë datë 03*****04*****2009*; ky akt përcakton se me vendimin nr*****10789, datë 03*****04*****2009, personit të quajtur Ermison Gila jepet përfitimsipas statusit të të verbërit, grup i dytë, me afat rikontrolli prill 2010; bashkëlidhur fotokopje e kartelës;

Këto rrethana që lidhen me nevoja të veçanta të jetës së të pandehurit Gila, pra nevoja për kujdesin ndaj babait dhe vëllait të sëmurë, justifikojnë këtë zgjidhje gjyqësore për të pandehurin: dënimi penal me burgim për të është arsyeshme të pezullohet dhe i pandehuri të vihet në provë***** Kjo, edhe në respekt të parimit të drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe të dënimit, si dhe bazuar në parimin e humanizmit që duhet të karakterizojë procesin penal nga fillimideri në caktimin e dënimit përfundimtar për një person që deklarohet fajtor përkryerjen e një veprë penale, të përcaktuara në nenin 1/c të KP*****

Sa sipër, konform nenit 59, pika 3 të KP, ekzekutimi i vendimit të dënimit me burg për të pandehurin pezullohet dhe i pandehuri ***** Gila vihet në provë për një periudhë kohe prej 5 (pesë) vjet***** Gjatë kohës së provës ai nuk duhet të kryejë vepër tjetër penale***** Në zbatim të nenit 60, pikat 9 dhe 10 të KP, urdhërohet i pandehuri Gila të mos shoqërohet me persona të dënuar dhe të mos zotërojë, mbajë apo përdorë armë***** Gjithashtu, gjatë kohës së provës, i pandehuri të mbajë kontakte me Degën Territoriale të Shërbimit të Provës Shkodër*****

• Urdhërimet e fundit

Pra sa më sipër, i pandehuri ***** Gila është hetur dhe gjykuar me masën e sigurimit personal “*arrest në burg*”***** Në kushtet kur nga gjykata u vendos pezullimi me kusht i ekzekutimit të dënimit me burgim për të pandehurin ***** Gila, i akuzuar për kryerjeve veprës penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, parashikuar nga neni 283, paragrafi i parë i KP, bazuar në nenin 261 të KPP nën titullin “**Shuarja e masës së sigurimit**”, ku parashikohet shprehimisht se: “1***** Masat e sigurimit shuhen: a) kur për të njëjtin fakt dhe ndaj të njëjtit person



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër

është vendosur pushimi i çështjes ose është dhënë vendimi i pafajsisë; b) kur dënimi i caktuar shpallet i shuar ose i pezulluar me kusht; c) kur kohëzgjatja e paraburgimit të vuajtur është më e madhe sesa e dënimit të caktuar; ç) kur pas mbarimit të afatit të parashikuar nga neni 245, paragrafi 1 shkronja "ç" nuk është urdhëruar përsëritja, brendakufijve të parashikuar nga nenet 264 dhe 267*****", në nenin 262 të këtij Kodin të titullin "Pasoja të shuarjes së masave të sigurimit", ku parashikohet se: "1***** Kur arrestimi e humbet fuqinë, gjykata vendos lirimin e menjëhershëm të personit ndaj të cilit është marrë masa***** 2***** Në rastet e humbjes së fuqisë së masave të tjera të sigurimit, gjykata vendos heqjen e menjëhershme të tyre*****", si dhe në nenin 389 të Kpp nën titullin "Disponimet mbi masat e sigurimit", ku parashikohet: "1***** Me vendimin e pafajësisë a të pushimit, gjykata urdhëron lirimin e të pandehurit të paraburgosur dhe deklaron heqjen e masave të tjera të sigurimit***** Në të njëjtën mënyrë disponohet edhe kur vendoset pezullimi me kusht i vendimit*****", gjykata vendos të deklarojë shuarjen e masës së sigurimit "arrest në burg" të caktuar ndaj të personit nën hetim ***** Gila me vendimin nr*****746, datë 08*****12*****2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër*****

Neni 485 i KPP, i titulluar "Shpenzimet e bëra nga shteti" parasheh që: "1***** Shpenzimet procedurale penale parapaguhet nga shteti, me përjashtim të atyre që lidhen me aktet e kërkuara nga palët private***** 2***** Në shpenzimet procedurale përfshihen shpenzimet e bëra në të gjitha fazat e procedimit për këqyrjet, eksperimentet, ekspertimet, njoftimet, për mbrojtësit e caktuar kryesisht dhe çdo shpenzim tjetër i dokumentuar rregullisht***** 3***** Në vendimin përfundimtar gjykata cakton detyrimin për pagimin e shpenzimeve të parapaguara nga shteti*****"

Duke qenë se, i pandehuri ***** Gila u deklarua fajtor dhe u dënua për veprën penale për të cilën akuzohet, bazuar në nenin 485 të KPP, shpenzimet procedurale në fazën e hetimeve paraprake si dhe shpenzimet gjyqësore të parapaguara nga shteti i ngarkohen atij*****

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, bazuar në nenet 379, 384, 389 e 390 të KPP,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit
të Përgjithshëm Shkodër

VENDOSI

-

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit ***** **Jonuz Gila** për kryerjen e veprës penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, parashikuar nga neni 283, paragrafi i parë i KP dhe në bazë të kësaj dispozitedënimit e tij me 5 (pesë) vjet burgim*****
2. Në zbatim të nenit 406 të KPP, dënimi prej 5 (pesë) vjet burgim ulet me 1/3e tij, duke u dënuar përfundimisht i pandehuri ***** **Jonuz Gila** me 3 (tre) vjet e 4 (katër) muaj burgim*****
3. Në zbatim të nenit 59 të KP urdhërohet:

-pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim*****

-vënia në provë e të pandehurit ***** **Jonuz Gila** për një periudhë kohe prej 5 (pesë) vjet, me kusht që gjatë kohës së provësai të mos kryejë vepër tjetër penale*****

-gjatë kohës së provës, i pandehuri ***** **Jonuz Gila** të mbajë kontakte me Degën Territoriale të Shërbimit të Provës Shkodër*****



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit
të Përgjithshëm Shkodër

1. Në zbatim të nenit 60, pikat 9 dhe 10 të KP, urdhërohet i pandehuri
***** **Jonuz Gila** të mos shoqërohet me persona të dënuar dhe të mos
zotërojë, mbajë apopërdorë armë*****
2. Në referim të nenit 261/1/b dhe 389 të KPP, deklarohet shuarja e
masës sësigurimit “*arrest në burg*”,parashikuar nga neni 238 i KPP,
caktuar me vendimin nr*****746, datë 08*****12*****2023 të
Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit tëPërgjithshëm Shkodër
ndaj të pandehurit***** **Jonuz Gila** dhe urdhërohet lirimi i
menjëhershëm i tij ngadhomat e paraburgimit, nëse nuk mbahet për
ndonjë arsye tjetër*****
3. Një kopje e këtij vendimi, pasi të ketë marrë formë të prerë, i dërgohet
Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë tëJuridiksionit të
Përgjithshëm Shkodër dhe Degës Territoriale të Shërbimit të Provës
Shkodër për të kontrolluar e verifikuar respektimin e detyrimeve
tëdhëna me këtë vendim nga i pandehuri*****
4. Shpenzimet procedurale gjatëhetimeve paraprake dhe ato gjyqësore
të parapaguara nga shteti lihen në ngarkim të pandehurit*****
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhetankim në Gjykatën e Apelit të
Juridiksionit të Përgjithshëm brenda 15(pesëmbëdhjetë) ditëve duke
filluar ky afat nga enesërmja e njoftimit të vendimit tëarsyetuar*****

U shpall sot në Shkodër, në datën 04*****03*****2025*****

SEKRETAREGJYQËSORE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit
të Përgjithshëm Shkodër**

GJYQTAR

**ADELA LIPE
ALBERT KERAJ**

[1] Shiko Vendimin Nr***** 141, datë 24*****04*****2013 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*****

[2] Shiko Vendimin unifikues Nr***** 3, datë 24*****01*****2011 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë*****

[3] Shiko për më tepër Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë Nr***** 1 i Regj***** Them***** , Nr***** 1 i Vendimit, dt***** 27*****03*****2008*****

Për keto arsye:

Baza Ligjore: *****



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër

Vendosi:

1***** Deklarimin fajtor të të pandehurit ***** **Januz ******* për kryerjen e veprës penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, parashikuar nga neni 283, paragrafi i parë i KP dhe në bazë të kësaj dispozite dënimit e tij me 5 (pesë) vjet burgim*****

2***** Në zbatim të nenit 406 të KPP, dënimi prej 5 (pesë) vjet burgim ulet me 1/3e tij, duke u dënuar përfundimisht i pandehuri ***** **Januz ******* me 3 (tre) vjet e 4 (katër) muaj burgim*****

3***** Në zbatim të nenit 59 të KP urdhërohet:

-pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim*****

-vënia në provë e të pandehurit ***** **Januz ******* për një periudhë kohe prej 5 (pesë) vjet, me kusht që gjatë kohës së provës ai të mos kryejë vepër tjetër penale*****

-gjatë kohës së provës, i pandehuri ***** **Januz ******* të mbajë kontakte me Degën Territoriale të Shërbimit të Provës Shkodër*****

4***** Në zbatim të nenit 60, pikat 9 dhe 10 të KP, urdhërohet i pandehuri ***** **Januz ******* të mos shoqërohet me persona të dënuar dhe të mos zotërojë, mbajë apo përdorë armë*****

5***** Në referim të nenit 261/1/b dhe 389 të KPP, deklarohet shuarja e masës së sigurimit "*arrest në burg*", parashikuar nga neni 238 i KPP, caktuar me vendimin nr*****746, datë 08*****12*****2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër ndaj të pandehurit ***** **Januz ******* dhe urdhërohet lirimi i menjëhershëm i tij nga dhomat e paraburgimit, nëse nuk mbahet për ndonjë arsye tjetër*****

6***** Një kopje e këtij vendimi, pasi të ketë marrë formë të prerë, i dërgohet Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër dhe Degës Territoriale të Shërbimit të Provës Shkodër për të kontrolluar e verifikuar respektimin e detyrimeve të dhëna me këtë vendim nga i pandehuri*****

7***** Shpenzimet procedurale gjatë hetimeve paraprake dhe ato gjyqësore të parapaguara nga shteti lihen në ngarkim të të pandehurit*****

8***** Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve duke filluar ky afat nga e nesërmeja e njoftimit të vendimit të arsyetuar*****

U shpall sot në Shkodër, në datën 04*****03*****2025*****

Ky dokument është marrë nga www.gjykata.gov.al. Ai ka vlerë të plotë informuese, por nuk shërben si dokument zyrtar. Ky i fundit lëshohet nga autoritetet përkatëse.